

VENDIM
Nr.179, datë 25.5.1990

PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË PRONËS SHETETËRORE

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Degët e arkave të kursimit dhe të sigurimeve bëjnë sigurimin e detyrueshëm të pronës shtetërore për:

- a) Mjetet kryesore të ndërmarrjeve.
- b) Automjetet e ndërmarrjeve e të institucioneve.
- c) Kulturat bujqësore dhe blegtorinë e ndërmarrjeve bujqësore.

2. Kushtet, objektet, rreziqet e sigurimit dhe primet caktohen me rregullore nga Ministria e Financave.

Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.1991.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI